



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 1227/15 Prot

Tiranë, më 30.04.2017

V E N D I M

Nr. 41, Datë 30.04.2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE LEZHË "MBI ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT TATIMOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË
ARDHURAVE TATIMORE, KONTRIBUTET E SIGURIMEVE
SHOQËRORE E SHËNDETËSORE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore" për periudhën nga 01.01.2014 – 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave tatimore u konstatua se për vitin 2014 plani është realizuar në masën 100% ose në vlerën 824,506 mijë lekë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë me mosrealizim në vlerën absolute 50,003 mijë lekë ose në masën 97%.

Plani i të ardhurave tatimore për vitin 2015 është realizuar në masën 106% ose në vlerën 922,463 mijë lekë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë me realizim në vlerën 1,670,218 mijë lekë ose në masën 104%.

Plani i të ardhurave tatimore për vitin 2016 është realizuar në masën 103% ose në vlerën 1,065,771 mijë lekë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë me realizim në vlerën 1,923,690 mijë lekë ose në masën 104%.

Për vitin 2014 të ardhura nga taksa nacionale janë realizuar në masë 132%. Për vitin 2015 të ardhurat nga taksa nacionale paraqiten me mosrealizim në masën 48% ndërsa për vitin 2016 të ardhurat nga kjo taksë janë realizuar në masën 142%.

Për vitin 2014 nga zëri të ardhura nga taksa e rentës minerare janë arkëtuar 5,937 mijë lekë, për vitin 2015 janë arkëtuar 6,309 mijë lekë dhe për vitin 2016 janë arkëtuar 2,684 mijë lekë. Gjatë vitit 2016 taksa e rentës minerare rezulton me ulje të ardhurash në shumën 2,684 mijë lekë. Objekt i kësaj takse janë 19 subjekte të cilët për pjesën më të madhe të muajve deklarojnë se nuk ushtrojnë aktivitet. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 65 dhe nr. 17-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, të bëhet analizë e detajuar e aktivitetit operacional në drejtim të realizimit sipas zërave të të ardhurave tatimore dhe të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për të identifikuar hartën e risqeve bazuar në tipologjinë e subjekteve që veprojnë në këtë drejtori, për të mundësuar marrjen e masave për të përmirësuar treguesit, kryesisht në tatimin mbi fitimin dhe TVSH, duke qenë se përbejnë 60% të planit.

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, për subjektet që kanë përgjegjësi tatimore taksën e rentës minerare, të cilat deklarojnë shitje me vlerë zero lekë ose me vlera shumë të vogla, të evidentojë, të shqyrtojë dhe dërgojë për kontroll këto raste mbi bazën e analizës së riskut. Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë të bashkëpunojë me AKBN-në për sasitë minerare për burimet natyrore që subjekti nxjerr nga mbi dhe nëntoka e territorit për të cilat duhet të paguajë rentë minerare.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Sektorit të Mbledhjes së Borxhit, u konstatua se për vitin 2014 borxhi tatimor në fund të vitit është në vlerën 3,773,175 mijë lekë, i cili krahasuar me vitin paraardhës është rritur në total për shumën 300,797 mijë lekë ose në masën 8%. Në totalin e borxhit detyrimet e papaguara tatimore janë në vlerën 3,537,884 mijë lekë, nga të cilat, detyrimet për TVSH janë në vlerën 2,129,889 mijë lekë ose në masën 56.4% e totalit të borxhit, detyrimet për tatim fitimin janë në vlerën 475,662 mijë lekë ose në masën 12,6%, të tjera detyrime tatimore janë në vlerën 932,323 mijë lekë ose

në masën 24,7%. Në totalin e borxhit për vitin 2014 detyrimet për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 235,291 mijë lekë ose 6.3% e të gjithë borxhit.

Për vitin 2015 borxhi tatimor në fund të vitit është në vlerën 4,496,671 mijë lekë, i cili krahasuar me vitin paraardhës është rritur për shumën 723,496 mijë lekë ose në masën 16%. Në totalin e borxhit detyrimet e papaguara tatimore janë në vlerën 4,165,171 mijë lekë, nga të cilat, detyrimet për TVSH janë në vlerën 2,426,187 mijë lekë ose në masën 54% e totalit të borxhit, detyrimet për tatim fitimin janë në vlerën 606,984 mijë lekë ose në masën 13.5%, të tjera detyrime tatimore janë në vlerën 1,132,000 mijë lekë ose në masën 25.1%. Në totalin e borxhit për vitin 2015 detyrimet për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 331,500 mijë lekë ose 7.4% e të gjithë borxhit. Për vitin 2016 borxhi tatimor në fund të vitit është në vlerën 4,779,785 mijë lekë, i cili krahasuar me vitin paraardhës është rritur për shumën 313,114 mijë lekë ose në masën 6.6%. Në totalin e borxhit detyrimet e papaguara tatimore janë në vlerën 4,376,277 mijë lekë, nga të cilat, detyrimet për TVSH janë në vlerën 2,566,288 mijë lekë ose në masën 53.7% e totalit të borxhit, detyrimet për tatim fitimin janë në vlerën 660,765 mijë lekë ose në masën 13.8%, të tjera detyrime tatimore janë në vlerën 1,649,484 mijë lekë ose në masën 36%. Në totalin e borxhit për vitin 2016 detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 403,508 mijë lekë ose 8.4% e të gjithë borxhit.

Efektiviteti i masave shtrënguese paraqitet i ulët. Për vitin 2014, nga marrja e masave shtrënguese në shumën 1,973,000 mijë lekë, janë arkëtuar 200,840 mijë lekë ose 10.2%. Për vitin 2015, nga marrja e masave shtrënguese në shumën 24,150,000 mijë lekë, janë arkëtuar 334,972 mijë lekë ose 1.4% dhe për vitin 2016, nga marrja e masave shtrënguese në shumën 22,050,000 mijë lekë, janë arkëtuar 459,820 mijë lekë ose 2%.

Nga auditimi rezultoi se Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, nuk i ka zbatuar rast pas rasti masat shtrënguese të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 88-101, si dhe kërkesat Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, të Miratuar nga Ministri i Financave, për arkëtimin e borxhit tatimor dhe ndjekjen rregullisht të subjekteve të cilat kanë krijuar një borxh të ri gjatë vitit 2016 në vlerën prej 313,114 mijë lekë, nga të cilat Tatim fitimi, 606 raste të reja në shumën 53,781 mijë lekë, TVSH, 2,112 raste në shumën 140,101 mijë lekë, Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 10,628 raste në shumën 82,008 mijë lekë dhe të tjera 582 raste në shumën 37,224 mijë lekë, duke ndikuar negativisht në performancën e mbledhjes së të ardhurave për vitin 2016.

Nga auditimi u konstatua se nga DRT Lezhë, për pagesën me këste të detyrimeve tatimore, për vitin 2014 janë lidhur 9 akt-marrëveshje në vlerë 31,600 mijë lekë, për vitin 2015, janë lidhur 10 akt-marrëveshje në vlerë 42,077 mijë lekë dhe për vitin 2016 janë lidhur 42 akt-marrëveshje në vlerë 138,593 mijë lekë, për të cilat nuk është respektuar afati 15 ditor për lidhjen e marrëveshjes, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 77.2, ku përcaktohet se kërkesa duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga data kur njoftimi i

vlërësimit konsiderohet të jetë marrë. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 118-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Mbledhjes së Borxhit, sipas debitorëve të evidentuar në regjistrin e borxhit, të marrë të gjitha masat shtrënguese sipas kërkesave të ligjit, për të bërë të mundur uljen e nivelit të borxhit tatimor.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të rimbursimit u konstatua se nuk është respektuar afati i rimbursimit 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga tatimpaguesi si dhe afati 60 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga tatimpaguesit eksportues, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 92/2014, nenit 77 “Rimbursimi i TVSH-së”.

Për subjektin “ ” me aktivitet në fushën e ndërtimeve, gjatë auditimit u konstatua. Me shkresën e Drejtorisë Përpunimit vlerësimit dhe Menaxhimit të Ardhurave në DRT Lezhë me nr.236, datë 05.03.2015 i është kërkuar Drejtorisë së Kontrollit për kontroll të thelluar për saktësimin e treguesve fiskal nga kontrolli i fundit. Me shkresën e Drejtorisë Përpunimit vlerësimit dhe Menaxhimit të Ardhurave në DRT Lezhë me nr.6976, datë 11.04.2016 i është kërkuar Drejtorisë së Kontrollit për kontroll të thelluar meqenëse me shkresën nr.1336, datë 18.08.2015 subjektit i është kërkuar paraqitje informacioni në lidhje me planimetrinë e objektit ku është përcaktuar pjesa e objektit për ambiente për tu shitur dhe pjesa e ambientit për tu shfrytëzuar nga vetë subjekti. Subjekti nuk ka paraqitur informacionin e kërkuar.

Me Kërkesën për Rimbursim nr.430, datë 30.06.2016 subjekti ka kërkuar Rimbursim të tepricës kreditore të TVSH-së për shumën 113,627,184 lekë.

Me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.21691/2, datë 18.07.2016 me lëndë: Dërgohet shkresë për veprim, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë është dërguar për kontroll kërkesa për rimbursim të TVSH-së për subjektin “ ” sipas kërkesës për rimbursim të protokolluar nr.21691, datë 04.07.2016 për shumën 113,627,184 lekë për periudhën e krijimit të tepricës kreditore të tvsh Qershor 2014-Prill 2015. Raporti i Kontrollit Tatimor është mbyllur me datën 17.10.2016 dhe është njohur për rimbursim shuma 89,353,703 lekë (diferenca nga kërkesa 24,273,481 lekë).

Gjatë auditimit të dokumentacionit të paraqitur u konstatuan të meta e mangësi: Për punimet e kryera sipas situacioneve për të cilat është kërkuar dhe miratuar rimbursimi i TVSH-së nuk është bërë analizë e çmimeve të punimeve dhe analizë teknike sipas manualeve të përcaktuara në Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.407, datë 02.07.2012, Nr.568, datë 27.6.2013, Nr. 629, datë 15.7.2014 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre” në të cilët janë përcaktuar cmimet për punimet e situacionuara.

Nuk janë analizuar sipërfaqet që sipas planimetrisë së objektit do të shfrytëzohen nga vetë shoqëria dhe sipërfaqja që do të jetë për tu shitur, në shkelje të kërkesave të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” Neni 20 ku përcaktohet: ... Është e rëndësishme dhe duhet të jetë qartësisht e përcaktuar që në fillim

të ndërtimit të objektit në planimetrinë e tij, pjesa që do të përdoret për shfrytëzim nga vetë personi i tatueshëm dhe pjesa që do të jetë ambiente për t'u shitur.

Nuk janë analizuar të ndara pjesa e punimeve të përbashkëta të situacionuara për objektin në shkëlje të kërkesave të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015“Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar “ Neni 20 pika 6 ku përcaktohet: ...Gjithashtu në përqindje ndërtuesi do të vlerësojë edhe ndajë edhe pjesën e punimeve të përbashkëta si themele, tarraca, korridore, ashensorë duke ndarë pjesën në përqindje që i takon shfrytëzimit të objektit për veprimtari të tatueshme dhe pjesën në përqindje që i takon objektit për veprimtari të përjashtuar. Nuk janë analizuar qartë në përputhje me planimetrinë e objektit pjesët përkatëse dhe qëllimi i përdorimit të tyre në shkëlje të kërkesave të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015“Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar “ Neni 20 pika 8 ku përcaktohet: Në çdo rast të përcaktohet qartë në lejet përkatëse përveç të dhënave që lidhen me ndërtuesin dhe investitorin, të dhënat për llojin e objektit, natyrën dhe qëllimin e përdorimit të tyre. Kur qëllimi i përdorimit të objektit është i përzier të jetë përcaktuar qartë në përputhje me planimetrinë e objektit pjesa përkatëse dhe qëllimi i përdorimit

Nuk janë bërë zberthime të normativave të përdorimit të mallrave e materialeve të blera për të cilat është kërkuar rimbursim dhe sa këto blerje i kanë shërbyer aktivitetit e shitjeve. Veprimi i mësipërm është në shkëlje të kërkesave të Manualit të Kontrollit Tatimor TP 4.3. Blerjet ku përcaktohet: Kryhet kontroll i zgjeruar për blerjet për t'u siguruar se ato janë për qëllime të aktivitetit ekonomik dhe për nevojat e tij, që kërkesat për rimbursim për blerje me TVSH nuk janë më të larta, dhe tatimi i zbritshëm për blerjet nuk është fshehur ose keq përshkrim si shpenzime për të rakorduar fshehjet e shitjeve të bëra.

Sipas Deklaratës për Punimet e Realizuara për periudhën nga data 31.01.2011 deri me datën 30.04.2014 janë deklaruar punime të realizuara në total për shumën 2,332,262,101 lekë, ndërsa sipas situacioneve të trajtuara në Raportin e Kontrollit janë deklaruar në vlerë të tatueshme për shumën 1,823,317,708 lekë me tvsh 364,663,541 lekë pra për një total në vlerën 2,187,981,249 lekë me diferencë 144,280,852 lekë. Për periudhën nëntor, dhjetor 2014 nga ana e inspektorit të kontrollit është argumentuar ulje e gjendjes kreditore të TVSH-së dhe kërkesës për rimbursim për shumën 13,487,370 lekë por nuk janë zbatuar kërkesat e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” për të llogaritur gjobë në shumën 2,953,734 lekë

Për subjektin “XXXXXXXXXX” me aktivitet Shërbime Portuale, u konstatua se me Kërkesën për Rimbursim dhe formularin Kërkesë për Rimbursim, datë 05.09.2014 subjekti ka kërkuar Rimbursim të tepricës kreditore për shumën 41,674,715 lekë. Sipas Raport Kontrollit datë 15.01.2015 është njohur për Rimbursim të TVSH-së shuma 41,674,715 lekë. Me Kërkesën për Rimbursim, datë 29.02.2016 subjekti ka kërkuar Rimbursim të tepricës kreditore për shumën 36,437,604 lekë. Sipas Raport Kontrollit datë 21.06.2016 është njohur për Rimbursim të TVSH-së shuma 35,272,360 lekë.

Gjatë auditimit të dokumentacionit të paraqitur u konstatuan këta të meta:

Për punimet e kryera sipas Situacioneve për të cilat është kërkuar dhe miratuar Rimbursimi i TVSH-së nuk është bërë analizë e çmimeve të punimeve dhe analizë teknike sipas manualeve të përcaktuara në Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.407,

datë 02.07.2012, Nr.568, datë 27.6.2013, Nr. 629, datë 15.7.2014 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre” në të cilët janë përcaktuar çmimet për punimet e situacionuara.

Nuk janë analizuar qartë në përputhje me planimetrinë e objektit pjesët përkatëse dhe qëllimi i përdorimit të tyre në shkëlqje të kërkesave të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” Neni 20 ku përcaktohet: *Duhet të përcaktohet në leje qartësisht lloji i objektit dhe përdorimi i tij, në mënyrë që të jetë i mundur të vërtetohet qëllimi i përdorimit në lidhje me veprimtarinë, pasi e drejta e zbritjes së TVSH-së për vetëfurnizimin ushtrohet më parë sesa të jetë provuar qëllimi i përdorimit të objektit të vetëfurnizuar për veprimtari të tatueshme.*

Nuk janë analizuar në mënyrë analitike situacionet sipas zërave të punimeve të kryera, materialeve të përdorura dhe elementëve të tjerë të punimeve sipas faturave të blerjes objekt ndërtimi sipas kërkesave të Ligjit Nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” Neni 99 pika 5 ku përcaktohet: *...Në ndërtim fatura tatimore duhet lëshuar çdo muaj.*

Nuk janë bërë zëbërthime të plota të normativave të përdorimit të mallrave e materialeve të blera për të cilat është kërkuar rimbursim dhe sa këto blerje i kanë shërbyer aktivitetit e shitjeve sipas kërkesave të: Manualit të Kontrollit Tatimor pika TP 4.3. Blerjet ku përcaktohet: *Kryhet kontroll i zgjeruar për blerjet për t’u siguruar se ato janë për qëllime të aktivitetit ekonomik dhe për nevojat e tij, që kërkesat për rimbursim për blerje me TVSH nuk janë më të larta, dhe tatimi i zbritshëm për blerjet nuk është fshehur ose keqpërshkrim si shpenzime për të rakorduar fshehjet e shitjeve të bëra.*

Nuk janë trajtuar në mënyrë analetike shitjet e tatueshme që ju përkasin shërbimeve të shkarkimit dhe ngarkimit të kontenierëve për mallrat e shërbimet përdorur brenda vendit, sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët Nr.31, datë 13.09.2010 germa h dhe i, të Ministrisë të Financave, Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrisë të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit.

Për subjektin “ ” me aktivitet përpunim, shitje e eksport fruta perime, u konstatua: Me Kërkesën për Rimbursim dhe formularin Kërkesë për Rimbursim, datë 06.08.2014 subjekti ka kërkuar Rimbursim të tepricës kreditore për shumën 5,050,669 lekë. Sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit protokolluar me nr.5971/2, datë 30.09.2014 subjektit i është miratuar për rimbursim shuma 3,172,685 lekë

Gjatë auditimit të dokumentacionit të paraqitur u konstatuan këta shkëlqje:

Për punimet e kryera sipas situacioneve për të cilat është kërkuar dhe miratuar Rimbursimi i TVSH-së nuk është bërë analizë e çmimeve të punimeve dhe analizë teknike sipas manualeve të përcaktuara në Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.407, datë 02.07.2012, Nr.568, datë 27.6.2013, Nr. 629, datë 15.7.2014 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre” në të cilët janë përcaktuar çmimet për punimet e situacionuara.

Nuk janë bërë zëbërthime të normativave të përdorimit të mallrave e materialeve të blera për të cilat është kërkuar rimbursim dhe sa këto blerje i kanë shërbyer aktivitetit e shitjeve. Për periudhën e kontrolluar nga ana e inspektorit të kontrollit është argumentuar ulje e tepricës kreditore të TVSH-së dhe kërkesës për rimbursim për shumën 1,488,503 lekë por nuk janë zbatuar kërkesat e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat

Tatimore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime neni 115 dhe 114 dhe Ligjit nr.84/2014 Date 17.7.2014, Neni 11 ku përcaktohet *Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar. Shumë e papaguar e detyrimit tatimor konsiderohet edhe ulja e tepricës kreditore të tatimpaguesit, në rastin e një rivlerësimi tatimor*”. Gjoha duhet të ishte llogaritur për shumën 325,982 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, Drejtoria e Kontrollit Operacional në raportet e kontrolli për miratimin e kërkesave për rimbursimin e TVSH-të bëhet një analizë e detajuar për blerjet me TVSH të kreditueshme, duke u siguruar se ato janë për qëllime të aktivitetit ekonomik.

Kontrolli i situacioneve të punimeve të analizohet duke u krahasuar me preventivat me qëllim që të vlerësohet me korrektësi detyrimin tatimor i një tatimpaguesi, duke kërkuar asistencë teknike edhe nga specialistë të fushës së ndërtimit.

Në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të bashkëveprojë me Drejtorinë e Hetimit Tatimor në rikontrollin ndaj subjektit “████████” me aktivitet në fushën e ndërtimeve, subjektit “████████” me aktivitet shërbime portuale dhe subjektit “████████” me aktivitet përpunim, shitje e eksport fruta perime.

Deri më 31.12.2017

4. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2014, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, kanë deklaruar humbje të vitit ushtrimor 144 tatimpagues në vlerë 198,305,569 lekë, nga të cilët 95 tatimpagues kanë rezultuar me humbje të vitit ushtrimor në shumën 117,371,724 lekë, si pasojë e shpenzimeve të panjohura prej tyre ose nga kontrolli tatimor.

Në vitin 2015 kanë deklaruar humbje të vitit ushtrimor 128 tatimpagues në vlerë 300,470,043 lekë, nga të cilët 59 tatimpagues kanë rezultuar me humbje të vitit ushtrimor në shumën 208,591,002 lekë, si pasojë e shpenzimeve të panjohura prej tyre ose nga kontrolli tatimor.

Nga të dhënat dhe dokumentacionit i paraqitur, rezulton se për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 numri i subjekteve me humbje ushtrimore është ulur nga 144 në 128 subjekte. Nga auditimi ka rezultuar se ulja e numrit të subjekteve nuk ka qenë në të njëjtin kah me uljen e humbjes në bilanc. Sipas të dhënave rezulton se humbja e vitit ushtrimor është rritur në shumën 102,164,474 lekë ose në masën 34% krahasuar me vitin paraardhës, si dhe humbja tatimore është rritur në shumën 91,219,278 lekë ose në masën 43,7%.

Drejtorja e Vlerësimit të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, bazuar në kriterin e mbartjes së humbjes deri në tre vjet, nuk ka mbajtur një evidencë të saktë, në mënyrë që të evidentoheshin të gjitha rastet me humbje. Nga auditimi ka rezultuar se nuk janë analizuar dhe nuk janë dërguar për kontroll rastet me humbje, me përjashtim të katër rasteve të cilët rezultojnë me humbje të konsiderueshme, si “████████”, “████████”, “████████”, “████████”.

Në vitin 2016, nga Drejtoria e Vlerësimit të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit nga 33 subjekte me humbje ka kërkuar çelja e procedurës së falimentit për 7 raste, duke kërkuar fillimin e procedurës së falimentimit pa analizuar shkakun e humbjes, bazuar në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat në RSH", i ndryshuar, neni 104 "Fillimi i procedurave të falimentimit", si dhe ligjin nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për Falimentimin", i ndryshuar me Ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008 si dhe Ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009, neni 14 pika 1.

Për 4 raste, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentit, për shkakun e mospërmbushjes së detyrimit ligjor të parapagimit të shpenzimit gjyqësor për shpërblimin e administratores së përkohshme të caktuar nga gjykata, me vlerë minimale 50,000 lekë/muaj. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 59-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe të kërkojë në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit duke analizuar shkakun e humbjes dhe përmbushur detyrimin ligjor për parapagimin e shpenzimeve gjyqësore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 104 "Fillimi i procedurave të falimentimit".

4.2. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, të evidentojë, shqyrtojë dhe të propozojë për kontroll, bazuar në analizën e riskut, subjektet që kanë deklaruar humbje të konsiderueshme të viteve ushtrimore, humbja e të cilave do të përbënte mbi 50% të humbjeve totale.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional rezultoi se për 2014 janë kryer në total 121 kontrole, nga të cilët 101 kontrole të plota dhe 20 kontrole vizitë fiskale e tematike. Nga kontrollet operacional (të plota) janë zbuluar detyrime në shumën 236,894 mijë lekë dhe ulje humbje në shumën 20,085 mijë lekë.

Nga sektori i kontrollit operacional për vitin 2015 në total janë kryer 27 kontrole nga të cilat 20 kontrole të plota dhe 7 vizita fiskale e tematike. Nga kontrollet operacional (të plota) janë zbuluar detyrime në shumën 50,770 mijë lekë dhe ulje humbje në shumën 13,313 mijë lekë. Viti 2015 krahasuar me vitin 2014 rezulton me ulje për 94 raste të kontrolleve të realizuara, ndërkohë që treguesi i zbulueshmërisë ka rënie me 186,124 mijë lekë ose është 79% më i ulët se viti paraardhës. Të dhënat reflektojnë rënie të zbulueshmërisë për kontroll në shumën 77 mijë lekë dhe rënie të zbulueshmërisë për inspektor në shumën 19,458 mijë lekë.

Nga sektori i kontrollit operacional për vitin 2016 në total janë kryer 57 kontrole nga të cilat 43 kontrole të plota dhe 14 vizita fiskale e tematike. Nga kontrollet operacional (të plota) janë zbuluar detyrime në shumën 255,913 mijë lekë dhe ulje humbje në shumën 48,734 mijë lekë. Viti 2016 krahasuar me vitin 2015 rezulton me rritje për 30 raste të kontrolleve të realizuara dhe me rritje të zbulueshmërisë me 205,143 mijë lekë. Të dhënat

reflektojnë rritje të zbulueshmërisë për kontroll në shumën 4,490 mijë lekë dhe rritje të zbulueshmërisë për inspektor në shumën 36,559 mijë lekë.

Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit u konstatuan të meta dhe mangësi në përshkrimet e raporteve të kontrollit, në të cilat mungonte një analizë e detajuar e Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve, veprime në mospërputhje me kërkesat e programit të kontrollit të parashikuar, metodologjisë së manualit të kontrollit tatimor, duke mos reflektuar përputhje me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Në analizën e importeve në praktikat e kontrollit mungojnë të dhëna për referencat doganore, për të mundësuar një analizë të shpenzimeve të deklaruar në FDP me shpenzimet në bilanc. Ky mos raportim krijon pamundësinë e evidentimit të përputhshmërisë së deklarimeve tatimore me legjislacionin, duke lënë vend për mospërputhshmëri në deklarimin e shumës së shpenzimeve, fshehje të vlerës së shtuar dhe eventualisht edhe të detyrimeve tatimore.

Për subjektin “██████████” me NIPT ██████████, nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se nuk është bërë analiza e shitjeve të përjashtuara, shitjeve të tatueshme, shitjeve me shumicë dhe pakicë, si dhe nuk janë trajtuar rimbursimet nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. Në analizën e të ardhurave të realizuara nga shitjet nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e VKM nr. 521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e Listës së Barnave që rimburohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” pika 4 .

Për subjektin “██████████”, me NIPT ██████████, sipas Raport Kontrollit Tatimor rezulton se mungojnë inventarët e kontrollit dhe inventarët e periudhës ushtrimore, mungon analiza e plotë e zërave të pasqyrave financiare, mungesa e të cilave nuk mbështet detyrimet e nxjerra në njoftim vlerësimin tatimor.

Për subjektin “██████████”, me NIPT ██████████, nuk është bërë analiza për kreditimin e TVSH-së për ndërtimin e objektit të ri, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 11 germa “c” dhe neni 53 “g”, si dhe Udhëzimi nr. 6, datë 31.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 20 “Punimet e ndërtimit. Nga analiza e TVSH-së, sipas programit të kontrollit, nuk është bërë analiza e kostos për njësi prodhimi (për 1 kg peshë e gjallë) i cili do të krahasohet me çmimin e shitjes së deklaruar nga shoqëria.

Për subjektin “██████████”, me NIPT ██████████, nuk janë analizuar të ardhurat për shitjet e përjashtuara për vlerën e komisionit të përfituar, sipas skemës së përcaktuar sipas në ligjin 7928/1998 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 19 “Furnizimet e përjashtuara” dhe Udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, paragrafi 9.3 “Furnizim cigareve”, nuk janë analizuar të ardhurat për furnizimin e shërbimeve arsimore, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit 7928/1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 24/1, nuk është trajtuar saktë vlera e mbetur e AAM dhe llogaritja e shpenzimeve të amortizimit sipas kërkesave të nenit 22 të ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor të merret në analizë performanca e ulët e kontroleve të realizuar, me qëllim që në të ardhmen të rritet eficaenca e strukturave të kësaj drejtori në luftën ndaj evazionit fiskal.

5.2. Rekomandimi Në çdo praktikë të realizuar nga Drejtoria e Kontrollit duhet të bëhet një analizë e hollësishme dhe e dokumentuar e shpenzimeve të subjektit, duke evidentuar tipin e faturimit, përfshirjen apo jo në Librin e Blerjeve dhe Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së, për të rakorduar blerjet e deklarimin në FDP me deklarimin në bilanc, si të shpenzimeve ashtu edhe të të ardhurave. Kjo analizë duhet të jetë pjesë e inventarit të dosjes dhe të evidentohet në çdo raport kontrolli.

5.3. Rekomandimi Në programet e kontrollit të vendoset si kërkesë e veçantë analiza e referencave doganore. Rezultatet e kësaj analize të përfshihen në raportin e kontrollit të subjektit duke pasqyruar veçmas vlerën e faturës së origjinës dhe vlerën e referencës doganore të aplikuar.

Në vijimësi

5.4. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, Drejtoria e Kontrollit Operacional të kërkojë rikontroll referuar nenit 85 pika “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, për parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit për subjektin “██████” Me NIPT ██████.

5.5. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, Drejtoria e Kontrollit Operacional të kërkojë rikontroll referuar nenit 85 pika “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, për parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit për subjektin në subjektit “██████”me NIPT ██████.

5.6. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, Drejtoria e Kontrollit Operacional të kërkojë rikontroll referuar nenit 85 pika “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, për parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit për subjektin në subjektit “██████”me NIPT ██████.

5.7. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, Drejtoria e Kontrollit Operacional të kërkojë rikontroll referuar nenit 85 pika “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, për parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit për subjektin në subjektit “██████”, me NIPT ██████.

Deri më 31.07.2017

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me

tatimpaguesin dhe institucionet eprore dhe paralele, me veprimet dhe mos veprimet e saj, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, i ka sjellë buxhetit të shtetit një nivel mungese të ardhurash në masën **63,598,557 lekë**, për të cilën kanë përgjegjësi personat konkretë të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë së Kontrollit Operacionl, për periudhën 2014-2016 është konstatuar shmangie në shumën 43,946,420 lekë për 23 subjekte, kryesisht nga mosllogaritja e tatim fitimi dhe TVSH-së. Nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit Operacional nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe udhëzimet në zbatim të tij, Ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, me ndryshimet dhe udhëzimet në zbatim të tij, Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, i ndryshuar dhe udhëzimet në zbatim të tij, Ligjit nr. 9975, datë 08.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, që përcaktojnë detyrimin tatimor si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 3.1.1 bashkëngjitur).*

1.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga 23 subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, në shumën 43,946,420 lekë.

Deri më 31.07.2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar në 68 raste mungesë e deklaratës të pagesës së qerasë, për efekt të llogaritjes së tatimit në burim mbi të ardhurat nga qeraja duke sjell efekt në shumën 366,123 lekë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33 germë “ë”, nenit 35 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, pikën 2.3.6 të Udhëzimit nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar, dhe nenin 117 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-36 Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.1 bashkëngjitur).*

2.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga 68 subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, në shumën 366,123 lekë.

Deri më 31.07.2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në një rast, sipas vendimit të ortakut, shoqëria ka vendosur të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë prej 7 milion lekë, më datën 29.12.2014 dhe ka paguar 10% të vlerës si tatim mbi dividentin në shumën prej 700,000 lekë, bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, nenit 33/1 “Depozitimi i vendimit pas miratimit të rezultatit vjetor dhe destinacionit të fitimit” ku cilësohet në pikën 1, “Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë

tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi". Dividenti është shpërndarja e fitimit pas tatimit për pronarët pas miratimit të rezultatit financiar. Dividenti është i lidhur me fitimin dhe referuar nenit 19 të Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.

Referuar Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, respektivisht SKK nr. 1 – Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, në pjesën e trajtimit të ngjarjeve pas përfundimit të periudhës raportuese cilësohet rasti: *Deklarimi i dividendëve pas përfundimit të periudhës raportuese*. Në këtë kontekst dividendi nuk mund të shkëputet nga momenti i miratimit të rezultatit financiar. Në rastin kur një njësi ekonomike u deklaron dividendët mbajtësve të instrumenteve të kapitalit neto të saj, pas përfundimit të periudhës raportuese, njësi ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si një detyrim në fund të periudhës raportuese. Tatimi i dividendit për rastin në fjalë është 15% e shumës së shpërndarë e cila duhet të raportohet në pasqyrat financiare të vitit 2014. Diferenca për tu paguar nga subjekti është në shumën prej 350,000 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave, për një subjekt në shumën 350,000 lekë.

Deri më 31.07.2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 33 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar në lidhje me mos dorëzimin brenda afatit ligjor, të vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit të rezultatit financiare të vitit ushtrimor 2013, për 27 subjekte me një efekt në shumën 740,000 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe në Aneksin nr. 2.1.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfitur apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 27 subjekte me një efekt në shumën 740,000 lekë.

Deri më 31.07.2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar 364 raste në të cilat mungojnë pasqyrat financiare të vitit 2013, 2014 dhe 2015, duke sjell një efekt financiar në shumën 3,640,000 lekë. Nga inspektorët e Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit nuk kanë është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 19, 29 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe nenit 126, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

-Nga auditimi u konstatua se inspektorët e vlerësimit nuk kanë penalizuar subjektet, që nuk kanë deklaruar formularin e deklarimit dhe pagesës për Tatimin mbi Fitimin për vitin 2013, veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 29.1. Nga mosveprimi referuar nenit 113 “Mosdeklarimi në afat, tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon deklaratën tatimore në afat, dënohet me gjobë me 10 000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar” të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rezulton me efekt financiar të munguar në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit në vlerën 120,000 lekë, për 12 subjekte.

-Nga auditimi rezultoi se inspektorët e vlerësimit, nuk kanë penalizuar subjektet, që nuk kanë dorëzuar në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 29. Mosveprimi nga inspektorët, përbën kundërvajtje administrative, referuar Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 113 “Mosdeklarimi në afat, tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon deklaratën tatimore në afat, dënohet me gjobë me 10 000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar”. Në vitin 2014 nuk kanë dorëzuar në organet tatimore brenda datës 31 mars, bilancin kontabël, 13 subjekte, në vlerën 130,000 lekë.

-Për vitin fiskal 2015 dhe 2016 nga rakordimi i të qarkullimit sipas TVSH-së dhe të ardhurave të tatueshme të deklaruara në FDP-në e tatim fitimit, rezulton se tatimpaguesit kanë deklaruar shitje të tatueshme dhe nuk kanë deklaruar formularin e pagesës së tatimit mbi fitimin dhe pasyrat financiare të vitit ushtrimor. Në këto raste, referuar Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, neni 68, pika 1, germa “c” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, paragrafi 72.1, 68.3.1 dhe 68.3.4, administrata tatimore ka detyrimin ligjor të përdorë mënyrën alternative të vlerësimit nga zyra, pasi personi i tatueshëm nuk ka respektuar detyrimin për të paraqitur deklaratën tatimore të tatimit mbi fitimit. Sa më sipër për periudhën 2014-2016 për 1 subjekt ose 2 raste, llogaritjen detyrime tatimor, me shmangie në shumën 3,871,052 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe në Aneksin nr. 2.1.2 dhe aneksi 2.1.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 413 raste me një efekt në shumën 7,761,052 lekë.

Deri më 31.07.2017

6. Gjetje nga auditimi: Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, në zbatim të Ligjit nr. 9136, datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore” i ndryshuar, dhe udhëzimeve në zbatim të tij, nga auditimi rezultoi se nga Drejtoria Përpunimit Menaxhimit dhe Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, për sigurimet shoqërore shëndetësore, janë llogaritur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mbi pagën minimale të miratuar. Për subjekte me veprimtari në fushën për sigurimin e objekteve publike e private nuk janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 75/2104, datë 08.08.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, Neni 18, pika “g” sipas të cilit paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit duhet të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për mbledhjen e sigurimeve shoqërore shëndetësore. Për periudhën 01.01.2014-31.12.2016 rezultuan, 7 raste me efekt në shumën 7,679,962 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr 129-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga 7 subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, në shumën 7,679,962 lekë.

Deri më 31.07.2017

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, sipas përshkrimit në aktkonstatim, nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 122 pika 1, germa a, b në lidhje me vendosjen e penalitetit për mosinstalim të pajisjes fiskale dhe për mos lëshimin e kuponit tatimor, për 27 raste (subjekte) me një efekt në shumën 2,755,000 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 107-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe në Aneksin nr. 3.1.2 bashkëngjitur).*

7.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga 27 subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, me një efekt në shumën 2,755,000 lekë.

Deri më 31.07.2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”:

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, sipas nenit 58 germa “ç”, rekomandohet masa “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civil:

1. **z. B. A.**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
2. **znj. M. K.**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, sipas nenit 58, germa “c”, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

3. **z. L. K.**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
4. **z. P. Ll.**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
5. **z. B. Z.**, Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren
6. **z. K. Gj.**, Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- a. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.*
- b. *Jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Manualin e Kontrollit dhe Verifikimit në terren.*
- c. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit 7928/1998 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar, i ndryshuar, ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe ligjit material. (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-107 dhe 107-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Menjëherë

Për përgjegjësitë dhe të metat e konstatuara, sipas Nenit 58, germa “c” “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

7. **z. Ll. N.**, Përgjegjës i Sektorit të Mbledhjes së Borxhit

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprime jo në

përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 118-129 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

Për përgjegjësitë dhe të metat e konstatuara, sipas Nenit 58, germa (b-c) nga “mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

8. z. P. D. ish Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit,

9. z. F. F. përgjegjës i Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit ,

10. znj. A. L. inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

11. znj. M. H. inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

a. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008;*

b. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;*

c. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit Manualit të Drejtorisë së Vlerësimit Tatimor; (Trajtuar më hollësisht në faqet 23-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Menjëherë

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, për punonjësit e larguar nga sistemi tatimor, sipas Neni 58 germa “ç”, janë në nivelin e masës “Largim nga shërbimi civil”, për të cilët, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rekomandimin e KLSH-së për punonjësit e mëposhtëm:

12. znj. M. S. ish - Drejtore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

13. z D. D. ish- Inspektore në Sektorin e Kontrollit Operacional

14. z. Gj. S. ish- Inspektore në Sektorin e Kontrollit Operacional

15. Z. M. M. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren

16. Z. A. M. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren

17. z. P. B. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren

- 18. z. F. N. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren
- 19. z. Gj. N. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren
- 20. z. M D ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren
- 21. z. E. S. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren
- 22. z. P. M. ish- Inspektore në Sektorin e Verifikimit në Terren
- 23. z. N. K. ish - inspektorë në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
- 24. z. A. Gj. ish - inspektorë në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- a. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.*
- b. *Jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Manualin e Kontrollit dhe Verifikimit në terren.*
- c. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit 7928/1998 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar, i ndryshuar, ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe ligjit material.(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-107 dhe 107-118 të Raportin Përfundimtare të Auditimit).*

Menjëherë

2. *Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësit, znj. M. M, znj A. D, z. J. K., z. Gj. F. nuk rekomandohet masë disiplinore, pasi mospërmbushja e detyrave prej tyre nuk është në nivelin e përgjegjësisë për fillimin e ecuresë disiplinore si dhe znj. Sh. R. e cila ka mbushur moshën e daljes në pension.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R